

Pozicioni i punës: Paketues

Kompania: ERA 2000

Përshkrim i shkurtër për kompaninë: Restorant – Piceri “ERA” filloi shërbimet e saj në vitin 1999. Kthimi në traditën shqiptare të gatimit dhe orientimi drejt kujdesit maksimal për klientin, bënë që “ERA” të shndërrohet shumë shpejt në një nga restorantet më popullore të kryeqytetit, me një menu të pasur të kuzhinës tradicionale shqiptare dhe mesdhetare.

ERA ishte e para që realizoi me sukses futjen e shërbimit “delivery” në Shqipëri. Prej 14 vitesh sjell një menu të pasur shqiptare tradicionale, mesdhetare dhe të huaj, kudo ku klientët ndodhen, në çdo kohë. ERA synon të jetë një nga modelet më të mira të biznesit shqiptar. E ndjeshme ndaj konsumatorit, e përgjegjshme ndaj cilësisë së produktit dhe kontributore kundrejt shtresave sociale në nevojë.

Produketet/shërbimet e ofruara nga kompania: Restorant/ Shërbim delivery

Adresa: Rruga “Sali Butka”

Përshkrimi i punës: I disponueshëm për të gjitha pozicionet

Qarkullimi i punonjësve: Mesatarja për industrinë

Departamenti: Departamenti I prodhimit

Koha punës në ditë: 4 orë

Statusi i punës: Me kohë të pjesshme, në mjediset e kompanisë dhe fleksibël me oraret

Përfitimet nga vendi i punës:

- Leje pune në rast sëmundje
- Pushime vjetore të paguara
- Vaktet e ushqimit

Niveli minimal i arsimit për pozicionin e punës: Më pak se shkolla e mesme

Përvoja e punës për të kryer këtë pozicion: Pa eksperiencë (e preferueshme deri në 1 vit eksperiencë)

Kërkesat e vendit të punës

Të parët:

Komunikimi verbal (Të folurit): Fjalimi i paqartë është i pranueshëm

Shkrimi funksional: Të shkruajë fjalë kyce, figura dhe/ose simbole

Leximi funksional: Të lexojë fjalë kyce, figura dhe/ose simbole

Kërkesat për të dëgjuarin: Kërkohet aftësi e arsyeshme

Bërja e llogaritjeve: Numërim i thjeshtë

Përqëndrimi: Ndërpritet cdo dy deri në tre orë

Ritmi i Punës: Ndonjëherë i shpejt

Numri dhe shpeshtësia e detyrave për t'u përmbushur: Dy deri në tre detyra me rradhë

Ndryshimet në rutinën e përditshme të punës: Asnjë ndryshim I detyrës

Kërkesat për të ndërmarrë iniciativë: Rrallëherë kërkohet që të marrë iniciativë

Ndërveprimi social (Me punonjësit/klientët e tjerë): Kontakt I kufizuar

Disponueshmëria e mbështetjes nga kolegët: Me ndërprerje

Konsiderata lidhur me aksesueshmerinë

- Biznesi është afër nga nga transporti publik
- Ka një hapësirë të aksesueshme udhëtimi nga rruga për në mjediset e kompanisë
- Ka ndricim të përshtatshëm në hapësirat e jashtme dhe në zonat kryesore të ndërtesës
- Sinjalistika jashtë dhe brenda vendit të punës është e madhe, e qartë dhe e lehtë për t'u lexuar por po punohet për ta bërë më të aksesueshme
- Diversiteti dhe gjithëpërfshirja artikulohe si vlera të rëndësishme të kompanisë
- Kompania ofron trajnime të stafit mbi diversitetin, përfshirjen dhe ndërgjegjësimin për çështjet e aftësisë së kufizuar
- Ekzistojnë politika dhe procedura të përshtatshme për të siguruar mosdiskriminim në vendin e punës

Procesi i aplikimit

Për të aplikuar për këtë pozicion pune, ju duhet të dërgoni një CV përmes faqes zyrtare www.era.al ne seksionin “Puno me ne” duke shprehur interes për këtë pozicion dhe duke specifikuar nevoja tuaja për të përshtatur pozicionin e punës